



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RAPORT PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR IMPORTIN, EKSPORTIN DHE TRANSITIN E ARMËVE TË ZJARRIT,
KOMPONENTËVE KRYESORË DHE MUNICIONEVE”

1. Titulli i projekt aktit

Projektligj “Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, komponentëve kryesore dhe municioneve”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Dokumenti u publikua në RENJKP, në adresën “konsultimipublik.gov.al”, në datën 1.10.2025 për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe shoqëria civile, deri në datën 29.10.2025, duke respektuar afatin ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre.

Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.

Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Projektligji “Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, komponentëve kryesore dhe municioneve”, u konsultua nëpërmjet metodave të mëposhtme:

- **Nëpërmjet RENJK:**

Me publikimin në RENJK (<http://10.253.31.44/PublicReports/Details/877>) u vendos një afat 22 ditor (ditë pune) për dhënien e sugjerimeve/komenteve mbi draftin e dokumentit.

- **Nëpërmjet adresës së emailit:**

Me qëllim lehtësimin e dhënies së komenteve/sugjerimeve nga çdo i interesuar, në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, në rubrikën e dedikuar për konsultimin publik, krahas draftit të projektligjit është vënë në dispozicion edhe adresa elektronike konsultim.publik@mod.gov.al.

- **Nëpërmjet adresës postare: “Rruga e Dibrës, Garnizoni “Skënderbej”, Tiranë”:**

Çdo palë e interesuar mund të dërgonte në formë shkresore, në adresë të Ministrisë së Mbrojtjes të gjitha komentet/sugjerimet mbi përmbajtjen e projektligjit.

- **Nëpërmjet zhvillimit të takimeve të drejtpërdrejta:**

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve. Diskutimet lidhur me këtë projektligj janë zhvilluar gjatë takimeve të grupit të punës.

4.Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara, të cilat morën pjesë në hartimin e këtij projekt akti janë:

- ✓ Ministria e Mbrojtjes;
- ✓ Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve

5.Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Projektligji është dërguar për mendim pranë:

- Ministrisë së Financave
- Ministrisë së Drejtësisë
- Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit

Ka patur 210 shikime në RENJKP, por nuk ka patur komente të mbledhura gjatë fazës së konsultimit publik, për projektligjin e konsultuar.

Komentet e ardhura nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera janë gjeneruar nëpërmjet sistemit e-Akte.

Nr.	Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komente (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi